GLN-ja është një lëng hidrokarboni shumë i avullueshëm, që zakonisht grumbullohet nën tryzni. Nëse trysnia çlirohet, sasi të mëdha gazi do të prodhohen, të cilat formojnë përzierje flakësh me ajrin mbi një diapazon prej 2% (V/V) deri 10% (V/V). Ky Standard Evropian përfshin kampionimin, dorëzimin dhe provën e GLN-së. Të gjitha procedurat duhet të kryhen larg nga burimet e ndezjes, siç janë flakët e pambuluara, pajisjet e pambrojtura elektrike dhe rreziqet elektrostatische. Prova duhet kryer sa më larg që të jetë praktike dhe nën një mbulesë ventilimi të sigurt nga ana elektrike.

GLN-ja në formë lëngu mund të shkaktojë djegie të ftohta të lëkurës. Veshjet mbrojtëse si dorashkat ose syzet, duhen veshur nëse ka gjasa që të ketë kontakt me lëkurën.

Thithja e panevojshme e aromës së GLN-së duhet shmangur. Operatori nuk duhet ekspozuar në atmosferë që përmban më shumë se 1 800 mg/m³ mbi një periudhë reference mesatare 8 herë më të madhe (TWA), ose më shumë se 2 250mg/m³ për një afat të shkurtër, një periudhë reference 10 minuta. Një nga provat e përshkruara në këtë Standard Evropian përfshin operatorin që thith një përzierje të ajrit me aromën e GLN-së. Një vëmendje e veçantë i kushtohet deklaratës paralajmëruese të ofruar në aneksin A.1, ku referohet kjo metodë.

2 Referencat normative

Dokumentat standarde të tenderit : “ Blerje karburant per automjete - Diesel “ viti 2017

Dokumentet e mëposhtme referuese janë të domosdoshme për aplikimin e këtij dokumenti. Për referencat e datuara, aplikohet vetëm botimi i cituar. Për referencat e padatuara aplikohet botimi i fundit i dokumentit referues (duke përfshirë edhe amendamente).

EN 15469:2007, *Produktet e naftës – Metoda e provës për ujën e lirë në lëngjet e naftës nëpërmjet inspektimit vizual*
EN 15470:2007, *Lëngjet e naftës – Përcaktimi i tepricave të tretshme – Metoda kromatografike e gazit në temperaturë të lartë*

EN 15471:2007, *Lëngjet e naftës - Përcaktimi i tepricave të tretshme – Metoda gravimetrike në temperaturë të lartë*

EN ISO 4256:1998, *Lëngjet e naftës – Përcaktimi i trysnisë së masës së avullit – Metoda GLN (ISO 4256:1996)*

EN ISO 4257:2001, *Lëngjet e naftës – Metoda e kampionimit (ISO 4257:2001)*

VULA

EN ISO 4259:2006, *Produktet e naftës – Përcaktimi dhe aplikimi të dhënave të sakta në lidhje me metodat e provës (ISO 4259:2006)*

EN ISO 6251:1998, *Lëngjet e naftës – Korrozioni i bakrit – Prova e veshjes së bakrit (ISO 6251:1996)*

EN ISP 8819:1995, *Lëngjet e naftës – Zbulimi i sulfidit të hidrogjenit – Metoda acetatit të plumbit (ISO 8819:1993)*

EN ISO 8973:1999, *Lëngjet e naftës – Metoda e llogaritjes për densitetin dhe trysinë e avullit (ISO 8973:1997)*

EN 589:2008+A1:2012 (E)

tekst i fshirë

EN 27941:1993, *Propani dhe butani tregtar – Analiza nëpërmjet kromatografisë së gazit (ISO 7941:1998)*

ASTM D 3246-05, *Metoda standarde e provës për përcaktimin e sulfurit total të avullueshëm në hidrokarbonet e gazit dhe lëngjet e naftës nëpërmjet mikrokulometrisë oksiduese*

ASTM D 6667-04, *Metoda standarde e provës për përcaktimin e sulfurit total të avullueshëm në hidrokarbonet e gazit dhe lëngjet e naftës nëpërmjet fluoreshencës ultraviolette*

3 Termat dhe përkufizimet

Për qëllimet e këtij dokumenti, aplikohen termat dhe përkufizimet e mëposhtme.

3.1

Gazet e lëngshme të naftës (GLN)

Gazi i naftës që mund të grumbullohet dhe/ose trajtohet në fazën e lëngshme nën kushte të matura të trysnisë dhe në temperaturë mjedisi, që përbëhen kryesisht nga propan, butan, sasi të vogla të propanit, butenit dhe pentanit

4 Kampionimi

Kampionët duhen marrë siç janë përshkruar në EN ISO 4257 dhe/ose në përputhje me kërkesat e standardeve ose rregulloreve kombëtare për kampionimin e GLN-ve automotive. Kërkesat kombëtare duhet të përcaktohen me detaje ose të referohen me referenca në një aneks kombëtar të këtij Standardi Evropian.

Për sa i përket ndjeshmërisë së disa metodave të provës të referuara në këtë Standard Evropian, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar përputhshmërisë me udhëzuesit ose kontenerët e kampionimit, që janë përfshirë në standardin e metodës së provës.

SHËNIM 1 Është e rëndësishme që procedura e kampionimit të zbatohet me detaje, në mënyrë që të shmangen humbjet e avullimit.

SHËNIM 2 Përpara kampionimit nga tubi nxjerrës, 20 litra produkt duhet të pompohen ose të riqarkullohen, në mënyrë që të merret një kampion përfaqësues.

VULA

5 Pompa e Shënimit

Informacioni që duhet shënjuar për pompat e shpërndarjes të përdorura për shpërndarje e GLN-ve automotive dhe përmasat e shenjës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e standardeve dhe rregulloreve kombëtare për shënjin e pompave për GLN-të automotive.

Kërkesa të tilla duhet të përcaktohen me detaje ose të referohen me referencë në një aneks kombëtar të këtij Standardi Evropian.

6 Kërkesat dhe metodat e provës

6.1 Përgjithësime

Kur testohet nga metodat e provës të dhëna në tabelën 1, lënda djegëse automotive GLN duhet të përputhet me kërkesat e kufizuar të përcaktuara në këtë tabelë.

Për minimumin e trysnisë së avullit, jepen pesë shkallë: A, B, C, D dhe E për të lejuar kufij sezonalë për t'u vendosur brenda vendit për çdo periudhë të vitit. Në një aneks kombëtar të këtij Standardi Evropian, secili shtet duhet të tregojë se cilën (cilat) shkallë adopton për të arritur një minimum trysnie avulli prej 150 kPa (masë) gjatë gjithë vitit dhe duhet të detajojë serinë e datave në të cilat do të aplikohet shkalla e përzgjedhur.

EN 589:2008+A1:2012 (E)

Tabela 1 – Kërkesat dhe metodat e provës

Prona	Njësia	Kufijtë	Metoda e provës^a
		Minimumi	(Shihni 2.

Dokumentat standarde të tenderit : “ Blerje karburant per automjete - Diesel “ viti 2017

		Maksimumi	Referencat normative)
Numri i oktanit për motor, MON		89,0	Aneksi B
Përmbajtja totale e dienit (duke përfshirë 1.3 butadiene)	mol %	0,5	EN 27941
Sulfiti i hidrogjenit		Negativ	EN ISO 8819
Përmbajtja totale e sulfurit ^b (pas kutërbimit)	mg/kg	50	Tekst i fshirë ASTM D 3246 ASTM D 6667
Korrozioni i zhveshjes së bakrit (1 h në 40°C)	klasifikimi	klasa 1	EN ISO 6251
Teprica e avullimit	mg/kg	60	EN ISO 15470 EN ISO 15471
Trysnia e avullit, masës në 40°C	kPa	1550	EN ISO 4256 EN ISO 8973 dhe Aneksi C
Trysnia e avullit, masa, minuta 150 kPa në temperaturë: ^{d,e} -për shkallën A -për shkallën B -për shkallën C -për shkallën D -për shkallën E	°C	-10 -5 0 +10 +20	EN ISO 8973 dhe Aneksi C
Përmbajtja e ujit ^f		Kalon	EN ISO 15469
Aroma		E pakënaqshme dhe e dallueshme në 20 % LFL	Shihni 6.3 dhe Aneksin A
<p>^a Shihni gjithashtu 6.5.1 ^b Shihni gjithashtu 6.5.2 ^c Shihni gjithashtu 6.5.3 ^d Për qëllimin e këtij standardi EN ISO 8973 së bashku me Aneksin C duhet të aplikohen në temperaturat e treguara. Për qëllime të brendshme rutinë për kontrollin e cilësisë, duhen përdorur vlerat e dhëna në Aneksin informativ D. ^e Shihni gjithashtu 6.1 ^f Shihni gjithashtu 6.2</p>			

6.2 Përmbajtja e ujit

Lëngjet e naftës për qëllime automotive nuk duhet të përmbajnë ujë të lirë në temperaturë 0°C dhe në tryzni avulli të ngopur për inspektimin vizual.

VULA

SHËNIM 1 Për përzierjet e pasura të propanit me një minimum prej 60% propan, përputhja me EN ISO 13758 [1] e përmbush njëloj këtë kërkesë.

Për qëllime operacionale lejohet që të shtohet 2 000 mg/kg metanol. Nuk duhen shtuar agjentë të tjerë antifrizë.

6.3 Aroma

Kur testohet në përputhje me procedurën e përshkruar Aneksin A, aroma e gazit duhet të jetë karakteristike (për shembull, e dallueshme dhe e pakëndshme), e kapshme në një përqendrim në ajër prej 20% të kufirit të ulët të ndezshmërisë.

EN 589:2008+A1:2012 (E)

SHËNIM Kur aroma është pakëndshme dhe subjektive, duhet treguar kujdes dhe përdoruesi duhet të kërkojë për rrjedhjen.

6.4 Densiteti

Nëse kërkohet raporti i densitetit, rekomandohen EN ISO 3993 [3] ose EN ISO 8973.

6.5 Precizioni dhe konflikti

6.5.1 Të gjitha metodat e provës të referuara në këtë Standard Evropian përfshijnë një deklaratë precizioni. Në rast të konfliktit, duhen zbatuar procedurat për zgjidhjen e tij dhe interpretimin e rezultateve bazuar në precizionin e metodës së provës, të përshkruar në EN ISO 4259.

6.5.2 Në rastet e konfliktit që lidhet me përmbajtjen totale të sulfurit, duhet të përdoret ASTM D 6667.

6.5.3 Në rastet e konfliktit që lidhet me trysinë e avullit, duhet të përdoret EN ISO 4256.

VULË

EN 5892008+A1:2012 (E)



Aneksi A
(normativa)

Metoda e Testit për aromën e GLN

A.1 Hyrje

Ky aneks përshkruan metodën për vlerësimin e aromës së GLN-së së tregtuar sa herë që kjo aromë vjen për shkak të prezencës së hidrokarboneve të pangopura ose për shkak të shtimit të aromatizuesve.

KUJDES – Në mënyrë për të reduktuar ekspozimin e personelit ndaj aromës gjatë testit, rekomandohet me insistim se testi duhet të kryhet vetëm atëherë kur vlerësohet se GLN përmbush të gjitha standardet e kërkuara dhe të specifikuara në Tabelën 1 të këtij Standardi Evropian. Testi kërkon që operatori të thithë një përzierje arome GLN-je dhe ajri. Ka një rrezik se kufijtë e ekspozimit afatshkurtër dhe afatgjatë ndaj substancave që përmban GLN-ja mund të tejkalohen. Operatori duhet t’u përmbahet rregullave përkatëse të sigurisë dhe shëndetit dhe të sigurohet se koha e ekspozimit ndaj kampionëve, mbajtjes në dorë, dhe testimit të GLN-së nuk i tejkalon kufijtë e përshkruar.

Si rregull, dhe duke pasur parasysh se GLN-ja që do testohet është në përputhje me kërkesat e listuara në Tabelën 1 të këtij Standardi Evropian, operatori do të qëndroj brenda limiteve të ekspozimit në punë. Kjo do të bëhet duke pasur parasysh se thithja e përzierjes së GLN-së me ajrin nuk i kalon tre herë nga 10 sekonda/për herë gjatë çdo testi dhe se nuk do të kryhen më shumë se dy teste në një orë gjatë një dite pune tetë orarëshe. Ky udhëzim nënkupton vetëm ekspozimin e operatorit gjatë kryerjes së testit të aromës.

A.2 Parimi

Një kampion i gazit të lëngshëm lihet të avullojë plotësisht dhe të tretet me ajrin kështu që përzierja përmban gaz në një përqendrim prej 20% e kufirit të poshtëm të djegies së vetë në ajër. Aroma e kësaj përzierje gazesh vlerësohet nga të paktën tre vëzhgues.

SHËNIM Kufiri i poshtëm i djegshmërisë në ajër është si vijon:

-butani 1.9% (V/V)

-propani 2.4% (V/V)

A.3 Materiali

Karbon i aktivizuar, madhësia e copëzave nga 1,18 mm deri në 1,70 mm, për të pastruar rrymën e ajrit.

A.4 Aparati

VULA

Aparati tregohet në diagramin në Figurën A.1 dhe konsiston në pjesët e detajuara në A.4.1 deri në A.4.5.

A.4.1 Kolona e pastrimit të ajrit konsiston në një gyp me kapacitet rreth 200ml.

A.4.2 Flowmeter [Floumetri] njësoj si ai punon bazuar në parimin e elementit notues, për ajrin; varion nga 5l/min deri në 15l/min.

A.4.3 Flowmeter [Floumetri] njësoj si ai punon bazuar në parimin e elementit notues, për gazin; varion nga 5ml/min deri në 150ml/min.

A.4.4 Provëza e përzierjes së gazit, 30 mm në diametër me një tub 4 mm në diametër

EN 5892008+A1:2012 (E)

A.4.5 Hinka e gazit, diametri 75 mm

SKICË ME SHUME SE GJYSMA E FAQES

Shpjegimi

1 ϕ 75 hinkë xhami	4 Floumetër	VULA
2 Provëza e përzierjes	5 Ajër	
3 Kolona e pastrimit të ajrit	6 Gazi me erë	

Figura A.1 – Aparati për vlerësimin e aromës së GLN-së

A.5 Procedura

Lëre ajrin të kaloj nëpër kolonën e pastrimit të ajrit (A.4.1) sipas normës së specifikuar nga fluometri i ajrit (A.4.2). Norma e rrjedhje së ajrit për propanin duhet të jetë 8,5 l/min, ndërsa ajo për butanin duhet të jetë 10,5l/min.

Vendoseni hundën te buza e hinkës (A.4.5) dhe merr frymë lirshëm; sigurohu që ajri të jetë pa aromë.

Gazi me erë duhet të kalojë nëpër fluometrin e gazit (A.4.3) në një nivel prej 40 ml/min.

Vlerësimi I aromës së përzierjes së ajrit me gazin duhet të kryhet nga të paktën tre vëzhgues.

A.6 Pasqyrimi i rezultateve

Nëse aroma gjykohet të jetë e pakëndshme dhe e veçantë nga të gjithë vëzhguesit, partia, nga e cila është marrë kjo mostër duhet të raportohet në përputhje me EN 589.

EN 5892008+A1:2012 (E)

Aneksi B
(normativa)

Metoda e llogaritjes së numrit të oktanit për motorin (MON) nëpërmjet analizave përbërëse të GLN-së

B.1 Hyrje

Ky aneks përshkruan metodën për llogaritjen e numrit të oktanit për motorin nëpërmjet analizave përbërëse të GLN-së.

B.2 Parimi

Përbërja e kampionit të GLN-së merret duke përdorur kromatografinë e gazit. Numri i oktanit i kampionit për motorin llogaritet nëpërmjet faktorëve të pjesshëm të numrit të oktanit të përbërësve dhe përqendrimeve të përcaktuara nga analiza.

B.3 Përcaktimi

Përcaktoni përqendrimin e secilit përbërës të pranishëm në përqendrim me një tepri prej 0,1 për qind mol në kampionin e gazit, duke përdorur metodën e përshkruar te EN 27941.

B.4 Llogaritja dhe pasqyrimi i rezultateve

B.4.1 Llogarisni numrin e pjesshëm të oktanit për motorin për secilin nga përbërësit në përzjerje, sipas formulës së mëposhtme:

$$\text{Numri i pjesshëm i oktanit} = M \times C$$

ku

M është faktori i oktanit për motorin e një përbërësi specifik (shihni tabelën B.1), në të njëjtat njësi të përdorura për *C*;

C është fraksioni i përbërësit specifik në përzjerje, qoftë përqindje molare, mase ose volumi.

SHËNIM Faktorët për numrin oktan për motorin në tabelën B.1 janë vlera empirike që përdoren vetëm për procedurat e llogaritjes në këtë Aneks.

Në rastet e konfliktit duhen përdorur faktorët molarë.

B.4.2 Shtoni numrat e pjesshëm të oktanit për motorin për të gjithë përbërësit e përcaktuar dhe rumbullakoseni shumën sa më afër 0,1.

VULA

B.5 Raportimi

Raportoni totalin (B.4.2) sipas kampionit të numrit të oktanit për motorin, për GLN-në.

EN 589:2008+A1:2012 (E)

Tabela B.1 – Faktorët për përcaktimin e Numrit të Oktanit për Motorin e GLN-së

Komponenti	Faktori i numrit të oktanit për motorin, <i>M</i>		
	Molar	Masa	Volumi
Propan (+ C2)	95,4	95,9	95,6
Propene	83,9	82,9	83,1
Butan (+ C5)	89,0	88,9	88,9

Dokumentat standarde të tenderit : “ *Blerje karburant per automjete - Diesel “ viti 2017* ”

2-Metilpropan (Isobutan)	97,2	97,1	97,1
Butenet	75,8	76,8	75,7

VULA

EN 589:2008+A1:2012 (E)

Aneksi C
(normativa)

Faktorët e përzierjes për presionin absolut të avullit (kPa)

Ky Aneks përshkruan faktorët për llogaritjen e trysnisë absolute të avullit për gazet e lëngshme të naftës. Duhet përdorur metoda e llogaritjes, ashtu si jepet te EN ISO 8973. ¹⁾

Tabela C.1 – Faktorët e përzierjes për presionin absolut të avullit (kPa)

Komponenti	Faktorët e përzierjes për presionin absolut të avullit (kPa) në temperaturë (°C)					
	-10	-5	0	10	20	40
Metan	21 334	22 742	24 211	27 333	30 707	38 230
Etan	1 873	2 128	2 407	3 040	3 781	5 613
Etilin	3 348	3 737	4 159	5 101	6 184	8 805
Propan	346	405	472	630	826	1 353
Propilen	437	510	591	785	1 024	1 661
Butan	71,26	86,64	104,5	149,2	207,6	376,9
Isobutan	109,9	132,3	158,1	221,4	302,7	531
1-Buten	87,91	106,8	128,8	183,4	254,4	457
Isobuten	90,17	109,5	131,9	187,6	259,9	466
Cis-2-Buten	59,63	73,11	88,94	126,7	181,5	336,5
Trans-2-Buten	67,13	81,90	99,16	142,3	199,1	364,8
1,2-Butadinë	43,65	54,08	66,49	98,26	141,3	272,2
1,3-Butadinë	81,55	99,45	120,3	172,2	240,2	436
Pentan	15,23	19,41	24,48	27,85	56,53	115,5
Isopentan	21,98	27,68	34,52	52,25	76,57	151,3
1-Penten	19,75	25,00	31,33	47,85	70,67	141,5

1) Burimi i të dhënave: faktorët e përzierjes së trysnisë së avullit të komponentëve të pranishëm në gazet e lëngshme të naftës, siç tregohet në tabelë, llogariten fillimisht duke përdorur të ashtuquajturit koeficiente të Antonit, të publikuara te [4].

VULA

EN 589:2008+A1:2012 (E)

Aneksi D
(informues)

Kufijtë e presionit sezonal për masën e avullit në 40 °C

Tabela D.1 - Kufijtë e presionit sezonal për masën e avullit në 40 °C

Shkalla	Minimum ^a (kPa)	Ekuivalenti për 150 kPa në (°C)
A	950	-10
B	800	-5
C	700	0
D	500	+10
E	275	+20

^a Këto trysni avulli llogariten duke përdorur vlerat e dhëna të EN ISO 8973 dhe bëhen vetëm për qëllime të brendshme rutinë për kontrollin e cilësisë.



VULA

EN 589:2008+A1:2012 (E)

Public Health Sector

Bibliografia

- [1] EN ISO 13757:1996, *Gazet e lëngshme të naftës – Përcaktimi i tepricave të vajit – Metoda me temperaturë të lartë (ISO 13757:1996)*
- [2] EN ISO 13758:1996, *Gazet e lëngshme të naftës – Vlerësimi i thatësirës së propanit – Metoda e valvulës së ftohtë (ISO 13758:1996)*
- [3] EN ISO 3993:1995, *Gazi i lëngshëm i naftës dhe hidrokarbonet e lira – Përcaktimi i densitetit ose densitetit relativ – Metoda e hidrometrit me trysni (ISO 3993:1984)*
- [4] *Karakteristikat e gazeve dhe lëngjeve*, REID, R.C., PAUSNITZ, J.M. dhe SHERWOOD, T.K., botimi i 3^{të}, 1997

VULA

\



STANDARD SHQIPTAR

S SH UNI
6579:2011

Lëndë djegëse të lëngëta për
përdorim termik civil dhe industrial
– Klasifikimi dhe karakteristikat



Liquid fuels for industrial and
domestic thermal purposes –
Classification and characteristics



DPS Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit
Adresa: Rruga “Mine Peza”, 143/3, Tiranë
Tel: + 355 4 22 62 55; Fax: + 355 4 24 71 77
E-mail: info@dps.gov.al

© DPS

Rishtypja është e ndaluar. E drejta ekskluzive për publikimin dhe shitjen e standardeve i takon DPS.

S SH UNI 6579:2011

Hyrje

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, DPS, është organizmi kombëtar i standardizimit që drejton punën për hartimin e standardeve shqiptare nëpërmjet komiteteve teknike.

DPS adopton standarde ndërkombëtare dhe europiane si standarde shqiptare. Drejtori i Përgjithshëm bën miratimin e tyre.

Standardet shqiptare miratohen nga komitetet teknike me shumicë votash. Anëtarët e komiteteve teknike janë specialistë të subjekteve shtetërore dhe private.

Standardi S SH UNI 6579:2011 është përgatitur nga DPS si standard shqiptar.

Standardi S SH UNI 6579:2011 botohet për herë të parë.



Standardet rishikohen kur është e nevojshme, prandaj është e domosdoshme që përdoruesi të marrë botimin e fundit si dhe amendamentet e tij, nëse ka të tilla.

Përmbajtja	Faqe
Parathënie	4
1 Fusha e zbatimit	4
2 Standardet referuese	4
3 Marrja e mostrës	6
4 Kërkesat dhe metodat e provës	6
4.1 Ngjyruesit dhe gjurmuesit	6
4.2 Shtesat	6
4.3 Esteret metilik të acideve yndyror.....	6
4.4 Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës në lidhje me to.....	7
4.5 Saktësia dhe dyshimi	7
Tabela 1 Klasifikimi i lëndëve djegëse, kërkesat dhe metodat e provave	8



Drejtoria e Përgjithshme të Standardizimit



S SH UNI 6579:2011

STANDARD SHQIPTAR

Lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial – Klasifikimi dhe karakteristikat

S SH UNI
6579:2011
ICS: 75.160.20

Aprovuar në Komitetin Teknik 19
Miratuar më 24.11.2011

Ky standard ka statusin e Standardit Shqiptar.

Ky standard shqiptar ekziston vetëm në gjuhën shqipe.

Parathënie

Standardi S SH UNI 6579:2011 u përshtat nga Komiteti Teknik 19, “Produkte naftë, lubrifikantë dhe produkte që lidhen me to”, sekretariatit të cilin e mban DPS-ja.

Këtij standardi shqiptar duhet t’i jepet statusi i një standardi kombëtar, nëpërmjet një akti ligjor brenda muajit Maj 2012 dhe standardet kombëtare që bien në kundërshtim me të cilin të shfuqizohen brenda muajit Maj 2012.

1 Fusha e zbatimit

Ky standard përcakton kërkesat dhe jep klasifikimin për një përdorim sa më të mirë të lëndëve djegëse të lëngëta, me origjinë nga nafta për përdorim termik civil dhe industrial.

Shënim: Për qëllimet e këtij standardi shqiptar, termat “% m” dhe “% vol.” janë përdorur për të paraqitur përkatësisht përqindjen në masë dhe përqindjen në vëllim.

2 Standardet referuese

Ky standard shqiptar përmban përcaktime nga publikime të tjera, me anë të referencave të datuara ose të padatuara. Këto referenca normative janë cituar në vendet e nevojshme në tekst dhe publikimet janë renditur më poshtë. Referencat e datuara, amendamentet e mëtejshme ose rishikimet e çdo publikimi të tillë, zbatohen për këtë standard shqiptar vetëm kur ato përfshihen në të, me anë të amendamentit ose rishikimit. Për referencat e padatuara, zbatohet botimi më i fundit i publikimit të referuar (përfshirë amendamentet).

S SH EN 116 Lëndë djegëse për motorët diesel dhe pajisje ngrohëse shtëpiake – Përcaktimi i pikës së taposjes së filtrit në të ftohtë





Dokumentat standarde të tenderit : “ Blerje karburant per automjete - Diesel “ viti 2017

S SH UNI 6579:2011

- S SH EN 12766-2 Produktet e naftës dhe vajrat e përdorur – Përcaktimi i BPK – ve dhe produktet në lidhje me ‘to – Llogaritja e përmbajtjes së BPK
- S SH EN 12766-3 Produktet e naftës dhe vajrat e përdorur – Përcaktimi i BPK – ve (derivatet e Benzenit të Poliklorinuar) dhe produktet në lidhje me ‘to – Pjesa 3: Përcaktimi dhe kuantifikimi (sasijimi) i përmbajtjes së terfenileve (difenilbenzeneve) të poliklorinuara (TPK) dhe toluen benzileve të poliklorinuara (TBPK) me anë të gazkromatografisë (GK) duke përdorur një dedektor (gjurmues) për kapjen e elektronit (DKE).
- S SH EN 13131 Metodat e provës për naftën dhe produktet e saj - Produktet e lëngta të naftës - Përcaktimi i përmbajtjes së nikelit dhe vanadit - Metoda spektrometrike e absorbimit atomik
- S SH EN 14078 Produktet e lëngshme të naftës - Përcaktimi i metilestereve të acideve lyrore (FAME) në distilatet e mesme - Metoda e spektroskopisë me rreze infra të kuqe
- S SH EN 14213 2003 Vajrat ngrohës - Metilesteret e acideve lyrore (FAME) - Kërkesat dhe metodat e provës
- S SH EN ISO 2719 Përcaktimi i pikës së flakërimit – Metoda Pensky-Martens me kupë të mbyllur (kroxhol) (ISO 2719:2002)
- S SH EN ISO 2592 Përcaktimi i pikës së flakërimit – Metoda Cleveland me kupë të hapur (kroxhol) (ASTM D-92)
- S SH EN ISO 3104 Produkte të naftës – Lëngjet transparentë dhe të errët – Përcaktimi i vizkozitetit kinematik dhe llogaritja e vizkozitetit dinamik. (ASTM D-445-11a)
- ASTM D1665-98 Përcaktimi i vizkozitetit specifik Engler në produktet e rënda
- S SH EN ISO 3170 Lëngjet e naftës – Marja e mostrës me dorë
- S SH EN ISO 3171 Lëngjet e naftës – Marja automatike e mostrës me tubacion (ISO 3171:1988).
- S SH EN ISO 3405 Produkte të naftës – Përcaktimi i karakteristikave të distilimit (ISO 3405:2000). (ASTM D-86)
- S SH EN ISO 3675 Nafta bruto dhe produktet e lëngëta të naftës – Përcaktimi laboratorik i densitetit – Metoda me hidrometër (ISO 3675:1998).
- S SH EN ISO 3735 Naftë bruto dhe mazut - Përcaktimi i mbetjes - Metoda e ekstraktimit

5



S SH UNI 6579:2011

S SH EN ISO 4259	Produkte të naftës – Përcaktimi dhe zbatimi i të dhënave të sakta në lidhje me metodat e provës (ISO 4259:1992, përfshirë Korrigjimin 1:1993)
S SH EN ISO 6245	Produkte të naftës – Përcaktimi i hirit (ISO 6245:2001)
S SH EN ISO 8754	Produkte naftë - Përcaktimi i përmbajtjes së squfurit – Spektrometria fluoeshente e shpërndarjes së energjise me reze x (ASTM D 4294-02)
S SH EN ISO 20884	Produkte naftë - Përcaktimi i përmbajtjes së squfurit në lëndët djegëse të lëngëta për automjete - Spektrometria fluoeshente me reze X në shpërndarjen e gjatësisë së vales (ASTM D2622)
S SH EN ISO 10370	Produktet e naftës - Përcaktimi i mbetjes së karbonit - Metoda mikro
S SH ISO 3016	Produkte naftë - Përcaktimi i pikës së rrjedhjes
S SH ISO 3733	Produkte naftë dhe materiale bituminoze - Përcaktimi i ujit - Metoda e distilimit
S SH ISO 3734	Produktet e naftës - Përcaktimi i ujit dhe mbeturinave mekanike në mazutet e naftës – Metoda me centrifuge
ASTM D 974:	Produkte të naftës – Përcaktimi i aciditetit dhe bazicitetit me metodën e titrimit të ngjyrës së indikatorit.

3 Marrja e mostrës

Mostrat duhen të merren siç përshkruhet në standardin S SH EN ISO 3170 ose në standardin S SH EN ISO 3171 dhe/ose në përputhje me kërkesat e standardeve kombëtare ose rregullore për marrjen e mostrës të lëndës djegëse për ngrohje industriale dhe shtëpiake.

Nga pikëpamja e ndjeshmërisë së disa metodave të provës që referohen në këtë standard shqiptar, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet përputhshmërisë të çdo udhëzimi për enët e marrjes së mostrës të cilat përfshihen në standardin e metodës së provës.

4 Kërkesat dhe metodat e provës

4.1 Ngjyruesit dhe gjurmuesit

Është i lejueshëm përdorimi i ngjyruesve dhe/ose i gjurmuesve. Duhet të përdoren ngjyrues dhe gjurmues sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi në këtë fushë.

4.2 Shtesat





S SH UNI 6579:2011

Lejohet përdorimi i shtesave me qëllim përmirësimin e cilësia së lëndës djegëse.
Rekomandohet përdorimin aditivëve të përshtatshëm, pa efekte anësore të njohur, në sasi të duhur.

4.3.1 Esteret metilik të acideve yndyror

Lejohet përdorimi i estereve metilik i acideve yndyror (FAME) të përzier me gazoil ose me vajra të djegshëm. FAME e përdorur duhet të jetë në përputhje me standardin S SH EN 14213.

4.4 Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provës në lidhje me to

Kur i nënshtrohen provave sipas metodave të treguara ne tabelen 1, lëndët djegëse dhe përzierjet e mundëshme me FAME (shih pikën 4.3) duhet të kënaqin kufijtë e treguar në tabelën 1.

Në rastin kur përmbajtja e FAME në gazoil ose ne vajin e djegshëm është më e madhe se 105 V/V) për përcaktimin e përmbajtjes së sqfurit duhet të përdoret metoda e përcaktuar në standardin S SH EN ISO 14596

Për përcaktimin e përmbajtjes së FAME në gazoil duhet të përdoret metoda e përcaktuar në standardin S SH EN ISO 14078.

4.5 Saktësia dhe dyshimi

Të gjitha metodat e provave të cilave ju referohet ky standard përfshijnë të dhëna të saktësisë në përputhje me standardin S SH EN ISO 4259. Në raste dyshimi, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe interpretimin e rezultateve të bazuara në saktësinë e metodës së provës duhen të përdoren procedurat e përshkruara në S SH EN ISO 4259:2006.



S SH UNI 6579:2011

Tabela 1 – Klasifikimi i lëndëve djegëse, kërkesat dhe metodat e provave

Lloji i lëngës djegëse	Njësia	Vajguri (kerosinë)	Gazoil ≤0,1	Gazoil >0,1	Lende djegese te lengeta te renda te naftes(heavy fuel oil)		Metodat e provës
					Solar	Mazut	
	Njësia	A	B	C	D	E	
Karakteristikat							
Pika flakërimit	°C	≥28	>55	>55	>65	>80	S SH EN ISO 2719 ASTM D-92
Indeksi i cetanit			≥42				
Masa vëllimore në 15°C	Kg/m ³	770 deri 830	815 - 875	815 - 875			S SH EN ISO 3675
Viskoziteti në 40°C	mm ² /s		2,0-7,4	2,0-7,4	-	-	S SH EN ISO 3104 ASTM D-445
në 50°C	mm ² /s		-	-	21-90	>90	ASTM D1665
në 50°C	°E						
në 100°C	mm ² /s				<12	>12	
në 100°C	°E				≤2	>2	
Distilimi në 150°C	%(v/v)	-	≤ ¹	≤ ¹			S SH EN ISO3405 ASTM D 86
në 210°C	%(v/v)	<90					
në 250°C	%(v/v)	≥65	<65				
në 300°C	%(v/v)			<60			
në 350°C	%(v/v)		≥85	<85			
Uji dhe mbetjet	%(v/v)	≤0,05	≤0,05	≤0,05			S SH ISO 3734
Uji	%(v/v)	shënja	shënja	shënja	≤2	shënja	S SH ISO 3733
Mbetjet	%(m/m)				≤0,5	≤0,5	S SH ISO 3735
Hiri	%(m/m)				≤0,1	≤0,2	S SH EN ISO 6245
korrozioni	vlerësim	1a	1a	1a			S SH EN ISO 2160
Pika e turbullimit	°C		≤0	≤0			S SH ISO 3016
Squlfuri	%(m/m)	≤0,2	≤0,1	≤1	≤5	≤7	S SH EN ISO 20884
Përmbajtja e koksit	%(m/m)				≤15	≤15	S SH EN ISO 10370
Nikel+Vanad	mg/kg	≤15	≤15	≤15	≤180	≤230	S SH EN 13131
PCB	mg/kg	<4	<4	<4	<4	<4	S SH EN 12766-2
PCT	mg/kg	<10	<10	<10	<10	<10	S SH EN 12766-3
Fuqia kalorifike	MJ/kg				≥40	≥40	S SH 3745
Ngjyra(2)		po	po				

Shënimi (1) :nuk është i nevojshëm kur pika e flakërimit është më e madhe, ose e barabartë me 65°C

Shënimi (2): është i detyrueshëm ngjyrosja,për produktet (A,B,C), sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi



Shtojca 11

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Sasia e mallit që kërkohet:

TABELA

Institucioni	Menyra e furnizimit	Fondi limit	Lende djegese per automjete karburant Diesel (Gazoil) AL ST EN 590:2013
Spitali Sarandë	Karte elektronike	1.947.780	1.947.780
		1.100.000	

Public Health Sector

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 10

[*Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet: **Rreth 13500 litra**

Afatet e lëvrimit: **Nga data e lidhjes se kontrates deri me 15.05.2017**



Shtojca 11

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: <input type="checkbox"/> Mall: <input type="checkbox"/> Punë: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____



Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006, Për Prokurimet Publike.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

¹ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

< **Emri** >

Shtojca 13

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[*Data*]

Për: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*]

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës*]

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.


Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____



[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

Public Health Sector

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Dokumentat standarde të tenderit : “ *Blerje karburant per automjete - Diesel “ viti 2017*

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Drejtuesi i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e Mallrave të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

“kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Entit prokurues dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

“çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

“Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe rrisqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.

“ Lëvrimi ” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi,

Dokumentat standarde të tenderit : “ *Blerje karburant per automjete - Diesel “ viti 2017* ”

tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

“Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

“Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.

“palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

“Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.

“Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.

“objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

“Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikant e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i parashtrijë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t’i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit qe siguron materialet.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Pershtatshmeria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorezojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
